

BULETIN JAVOR

22-26 PRILL 2023



Shprehja

Duhen 20 vjet për të krijuar një reputacion dhe një incident kibernetik i vetëm, për ta shkatërruar atë.

e javës

Përmbajtja:

- RSA Conference 2023
- European Cyber Agora
- CISCO - CVE Disclosure
- ORACLE - Patching Alert



RSA CONFERENCE

Shqipëria, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK Z. Igli Tafa, prezantoi sfidat me të cilat po përballlet vendi ynë dhe hapat progresive që po ndërmerren, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

Çdo vit konferenca mbledh liderët e sigurisë kibernetike me qëllim ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis vendeve pjesëmarrëse, shkëmbimin e praktikave më të mira për rritjen e kapaciteteve dhe shkëmbimin e informacioneve mbi përdorimin dhe menaxhimin e sigurtë të produkteve e shërbimeve të sigurisë kibernetike.

Link: [Lexo lajmin e plotë](#)



Ndërsa strategjia e politikave të sigurisë kibernetike të Bashkimit Evropian hyn në vitin e saj të tretë, rritja e qëndrueshmërisë kibernetike dhe avancimi i prioriteteve të diplomacisë kibernetike të BE-së, mbeten prioriteti më i madh, për t'iu përgjigjur një mjedisi gjithnjë e më sfidues digjital.

Link: [European Cyber Agora | Microsoft](#) (25-26 Prill)



Cisco ka publikuar një vulnerabilitet të tipit Zero Day Attack në softuerin Prime Collaboration Deployment (PCD) të kompanisë, i cili mund të shfrytëzohet për sulme *cross-site scripting*.

Ky vulnerabilitet identifikohet me CVE-2023-20060

Link: [Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Oracle ka publikuar buletin me 433 Patching Alerts për vulnerabilitete të identifikuara në kodin e tij dhe në komponentë të ofruara nga palët e treta.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit të aplikojnë menjëherë përditësimet e sigurisë.

Link: [Oracle Critical Patch Update Advisory - April 2023](#)